

Shoqeria "NDERMARJA E UJESJELLSIT PATOS" sha

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i pergjithshem

Shoqeria "NDERMARJA E UJESJELLSIT PATOS" sha eshte e regjistruar si shoqeri anonime me vendim te gjykates te Rrethit Tirane Nr.25657, dt 12.12.2002. Shoqeria ka si objekt te saj Prodhimin dhe furnizimin me uje te popullates dhe subjekteve qe veprojne ne qytetin e Patosit me fshatrat.

Statusi juridik i shoqerise eshte Shoqeri Anonime.

Shoqeria "Ujesjelles" sha Patos ka kaluar ne vartesi te Bashkise Patos me date 15.01.2008.

Shoqeria ka si organ vendimor:

- Asamblene e Pergjithshme,
- Keshillin Mbikqyres si dhe,
- Drejtorine e Pergjithshme.

2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm

për të shkakuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe ekspertencën e mëparshme në gregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të gdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkohen në nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konfliktive gjyqësore. Shogëria vlerëson mundësinë e krizimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shogëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të gdo periudhe në rast se ka nevojë për krizimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kontabël të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshim në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbëhen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura

në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

1.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në

kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve Metoda e Amortizimit		Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Tubacione	Vlera e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

1.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

1.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

1.7 Qiratë

Qiratarjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

1.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursit i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursit i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogaritë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

1.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përmes rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur dhe mund të ardhmen në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

1.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

1.11 Transaksionet me palët e lidhura

Mikrofinans

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

1.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

1.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Postet e bilancit paraqiten:

Shenimet që shpjegojnë zërat e pasqyrave kryesore

1-Aktivet monetare për 2.136.210 leke paraqesin mjetet monetare në bankë në datën 31.12.2019. Shoqëria kryen veprimet me disa banka, të gjitha veprimet janë regjistruar në ditaret perkates dhe shuma e paraqitur në bilanc perputhet me nxjerrjen e bankave të shoqërisë në datën 31.12.2019.

3-Te drejta të arketueshme me vlerë 168.040.889 leke detajohen si më poshtë :

(i) Nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerë 30.579.392 leke paraqesin llogarinë kliente për vlerën e faturave të paarketuara në shumën 72.531.633 leke dhe pakesuar për provizionin e krijuar për klientet pa shprese arketimi në shumën 41.952.241 leke (gjatë këtij ushtrimi shoqëria ka llogaritur shpenzime për provizionimin e klienteve në shumën 16.995.181 leke).

(ii) Te tjera të drejta të arketueshme në shumën 137.461.497 leke paraqesin:

- tvsh kreditore në shumën 129.316.478 leke,
- parapagime për punonjësit në shumën 6.682.735 leke,
- të tjera kërkesa debitore në shumën 1.883.773 leke nga të cilat janë provizionuar debitore pa shprese arketimi shuma 371.489 leke.

4-Inventari në shumën 7.758.235 leke përbehet nga materiale të para dhe të tjera në shumën 6.183.121 leke dhe inventar i imet në shumën 1.575.114 leke. Inventari është prone e shoqërisë dhe justifikohet me inventarin fizik të tyre, vlerësimi është me kosto.

II. Aktivet afatgjata

Duke shprehur me

2-Shoqeria ka nje vlere neto aktiveve afatgjata materiale ne shumen 214.193.876 leke te cilat paraqiten te detajuara si vijon:

Vlera neto e Aktiveve afatgjata

Emertimi	Vlera e mbetur 2018	Shtesat 2019	Dalje jashte perdorimi vlera fillestare	Amortizimi mjeteve te dala jashte perdorimit	Amortizimi 2019	Vlera e mbetur
ndertesa	15,258,139				762,907	14,495,232
tubacione	177,903,417	19,569,141			9,220,587	188,251,971
makineri e pajisje	11,578,470	459,390	8,653,761	7,788,385	2,343,124	8,829,360
mjete transporti	1,129,648				225,930	903,718
pajisje zyre dhe inform	1,605,508	100,000			321,102	1,384,407
prodhim ne proces	-					-
totali	207,475,183	20,128,531	8,653,761	7,788,385	12,873,649	213,864,689
aam jo materiale	415,438				86,250	329,188
totali	207,890,620	20,128,531	8,653,761	7,788,385	12,959,899	214,193,876

Aktivitet afatgjata materiale jane prone e shoqerise, shtesat jane te justifikuar me dokumenta, amortizimi eshte llogaritur sipas ligjit fiskal, vleresimi eshte bere me kosto. Aktivitet afatgjata materiale jane shtuar ne shumen 20.128.532 leke ne zerin tubacione, ne shumen 19.569.141 leke, ne zerin makineri e paisje per shumen 459.390 leke, ne zerin paisje zyre e kompjuterike ne shumen 100.000 leke. Aam jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 12.959.899 leke, gjithashtu aam jane zvogeluar per vleren e mbetur te aam-ve te nxjerra jashte perdorimit ne shumen 865.376 leke.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Detyrimet afatshkurta jane leke te detajuara si vijon:

- 1.Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit 113.442.339 leke.
- 2.Ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore 30.929.705 leke,
- 3.Detyrimet tatimore 8.548.767 leke,
- 4.Te tjera 409.416 leke.

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit paraqesin llogarine furnitore per detyrimet te krijuara ne kete ushtrim, te cilat kryesisht jane per blerje energjie elektrike.

Ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore ne shumen 30.929.705 leke paraqesin detyrim per sigurimet shoqerore ne shumen 29.638.230 leke, paga te keshillit mbikqyres ne shumen 1.283.622 leke dhe paga te punonjesve 7.853 leke.

Detyrimet tatimore ne shumen 8.548.767 leke paraqesin detyrimet per TAP ne shumen 7.694.243 leke, tatim ne burim 854.524 leke.

Te tjera detyrime ne shumen 409.416 leke paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve.

II-Detyrimet afatgjata me vlere 896.959.503 leke paraqesin detyrime te viteve te kaluara te shoqerise ndaj furnitoreve.

Te ardhura te shtyra: Grantet ne shumen 155.525.344 leke paraqesin subvencionet per investime, pjesa e rimarrjes eshte bere me te njejten norme si edhe amortizimi i am-ve ne shumen 8.156.475 leke.

Kapitali

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte 14.530.000 leke, ai perputhet me kapitalin e regjistruar ne regjistrin tregtar, aksioner i vetem eshte Bashkia Patos.

Rezerva ligjore eshte 1.415.000 leke.

Rezerva te tjera eshte 579 leke, e pandryshuar nga viti kaluar.

Humbja e mbartur ne shumen 727.011.593 leke e cila paraqet humbjet e viteve te kaluara ne shumen 628.598.913 leke te shtuar me humbjen e ushtrimit 2018 ne shumen 98.412.680 leke

Shoqeria per vitin 2019 ka dale me humbje ne shumen 102.619.850 leke.

TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Te ardhurat dhe shpenzimet jane si me poshte:

Shitjet neto jane 40.283.678 leke, jane te ardhura te realizuara nga aktiviteti kryesor qe eshte prodhim shitje uji i pijshem ne shumen 36.891.678 leke, tarifa 2.995.800 leke dhe takim linje ne shumen 339.250 leke, te ardhura nga ndryshimi emrit ne shumen 12.250 leke deh ndryshim libreze ne Shumen 44.700 leke.

Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit ne shumen 55.930.687 leke jane Subvencione te shfrytezimit ne shumen 55.930.687 leke.

Te ardhura te tjera financiare ne shumen 8.156.475 leke paraqesin:

1. Rimarrje amortizimi ne shumen 8.156.475 leke (subvencione per investime).

Materialet e konsumuara ne shumen 106.311.030 leke jane materiale te para dhe materiale te tjera ne shumen 14.803.884 leke dhe energji e blere ne 91.507.146 leke te cilat jane perdorur per veprimtarine kryesore te shoqerise.

Kosto e punes ne shumen 67.164.040 leke paraqet pagat e punetoreve ne shumen 57.552.735 leke dhe sigurimet shoqerore ne shumen 9.611.305 leke.

Amortizimi ne shumen 12.959.899 leke eshte llogaritur sipas fiskut dhe vlere e mbetur e am-ve jashte perdorimit ne shumen 865.376 leke.

Shpenzime te tjera ne shumen 19.690.345 leke eshte si me poshte:

- Sherbime postare ne shumen 385.890 leke.
- Kancelari ne shumen 149.994 leke.
- Punime mirembajtje dhe sherbime 305.066 leke.
- Komisione banke 19.860 leke.
- Personel i jashtem, auditim 410.000 leke.
- Paga e keshillit mbikqyres 922.560 leke.
- Shpenzime siguracioni 121.594 leke.

Subskruar

- Shpenzime djeta 71.000 leke.
- Shpenzime qeraje 36.000 leke.
- Shpenzime taksa 2.400 leke.
- Ndhime per fatkeqesi 196.000 leke, leke,
- Shpenzime gjoba dhe demshperblim 74.800 leke.
- Shpenzime per provizionim te klienteve pa shprese arketimi ne shumen 16.995.181 leke.

Humbje e ushtrimit eshte 102.619.850 leke

Shenime te tjera shpjeguese

Pasqyrat financiare jane individuale, jane hartuar nga K/degese se finances Rajmonda Vela.

HARTUESI
Rajmonda Vela

Rajmonda Vela

Drejtori
Petrit Elmazaj

